



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.18, datë 28.02.2020

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË SUBJEKTIT ZHVILLUES TË OBJEKTIT:
“NDËRTIMI I HIDROCENTRALIT OSOJE”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 13, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit “FAVINA” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e subjektit zhvillues të objektit “Ndërtimi i Hidrocentralit Osoje”, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 17, datë 16.10.2017, nga “FAVINA” sh.p.k, në “OSOJA-HPP” sh.p.k.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT


LEDIA TOTA

